

VENDIM
Nr.2, datë 2.2.2015

**PËRLICENCIMIN E SHOQËRISË “FATLUM” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “PERROLLAJ” ME FUQI TË
INSTALUAR 0.5 MW**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pikat 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.2.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga HEC “Perrollaj”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- dokumentacioni i përgjithshëm i përcaktuar në: nenin 9, pikat 1 (formatin e aplikimit); nenin 9, pikat 2 (dokumentacionin juridik, administrator dhe pronësor); nenin 9, pikat 3 (dokumentacioni financiar dhe fiskal) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licencës të përcaktuara në: nenin 9, pika 4.1.1 (të dhëna specifike për HEC); neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin); neni 9, pika 4.1.3 (dokumentacioni teknik dhe grafik); neni 9, pika 4.1.4 (dokumentacioni tekniko-ekonomik); neni 9, pika 4.1.5 (leje nga institucione të tjera), është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “FATLUM” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Perrollaj”, me fuqi të instaluar 0.5 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti